



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr.142/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbare të kreditorit SEFERI-CO” sh.p.k, me NUI:810100537, me seli në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës, kundër debitorit Komuna e Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2384/22 të datës 29.09.2023, me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2384/22 e datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.142/23 të datës 29.09.2023, ka refuzuar propësimin e debitorit Komuna e Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbare P.nr.320/21 të datës 06.08.2021, të Përmbaresit Saranda Kuqi, me seli të zyrës në Prizren, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2384/22 të datës 29.09.2023, dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori SEFERI-CO” sh.p.k, me dt. 06.08.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.38 të datës 20.05.2021, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit shumën prej 65,044.83 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e arritjes së kërkesës për pagesë, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Bllokohen të gjitha llogaritë bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartet mjetet nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit, kurdo që merret informacion nga kreditori apo përmbaruesi për ekzistimin e atyre mjeteve në llogari të debitorit. Regjistrohet, sekuestrohet dhe shitet pasuria e debitorit, si në sende të luajtshme, po ashtu edhe në paluajtshmëri në tërë masën pasurore të debitorit, derisa të përmbushet tërësisht obligimi i të njëjtit ndaj kreditorit.

Kundër urdhrit të përmbaruesit privat mbi caktimin e përmbarimit, brenda afatit të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori i përmbarimit duke theksuar se për fazën e tretë (përfundimtare të projektit “Projekt me bashkëfinancim-Ndërtimi i rrugëve lokale me karakter regjional-viset rurale në Suharekë”, të gjitha obligimet financiare i ka marrë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku kjo shihet edhe me nenin 1. Tutje ka theksuar se pagesa është e rregulluar me nenin 2.4 të kësaj Kontratës nr.624-20-055-521/624-20-2759-521, ku thuhet se “Pagesat do të bëhen konform marrëveshjes së MZHR-së dhe Komunës”. Prandaj, komuna si autoritet kontraktues, faturat të cilat janë objekt i përmbarimit i’ka dërguar Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për kryerjen e pagesës siç shihet nga komunikimi elektronik nga Berat Kabashi, menaxher i Kontratës nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, i cili ka deklaruar se ka pranuar faturat për pagesë dhe i njëjti ka kthyer përgjigje se projekti është përfunduar dhe është në proces të pranimit teknik, dhe vlera e mbetur e pa paguar do të kryhet deri në përfundim sipas kontratës. Pra, komuna nuk ka asnjë obligim financiar ndaj kreditorit, pasi që këtë obligim e ka Ministria e Zhvillimit Rajonal, dhe me këtë është i njoftuar edhe vet kreditori që nga momenti i nënshkrimit të kontratës. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit në tërësi si i bazuar, dhe të anulohet urdhri i lartcekur si i palejuar.

Kreditori i përmbarimit ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar, ngase pretendimet e paraqitura në prapësim nuk qëndrojnë dhe janë thjeshtë arsye për zvarritjen e procedurës së përmbarimit. Tutje ka theksuar se debitori është paralajmëruar që të bëjë pagesën, ku në fatura gjendet nënshkrimi nga ana e debitorit, ku raporti i pranimit të faturave si dhe situacioni i pranimit të furnizimeve, të gjitha këto të pranuar me nënshkrimin nga ana e debitorit që kuptohet se është në pajtim me të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së, ngase propozimi mbështetet në dokumentin e besueshëm, autentik dhe gjithashtu kërkesa është bërë e arritshme. Ngase me dispozitën e nenit 29 par.3 të LPP-së thuhet që dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar me çka e konteston përprjekjen dhe arsyen e debitorit për prapësim të urdhrit përmbarimor, ku shihet qartë se dokumentet (faturat) e besueshme korrespondojnë në bazë të nenit 29 pika 3. Po ashtu, ka theksuar

se debitori nuk ka ofruar prova të mjaftueshme në bazë të së cilës i mbështet kundërshtimet e tij, andaj në rastin e vendosjes kërkojmë nga gjykata që të i referohet nenit 69 par.4 të LPP-së, i cili thekson se “Baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim përndryshe prapësimi do të refuzohet”. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, si dhe të obligohet Komuna e Suharekës ti paguaj obligimet si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbarimit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2384/22 të datës 29.09.2023, ka refuzuar prapësimin e debitorit Komuna e Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.320/21 të datës 06.08.2021, të Përmbaruesit Saranda Kuqi, me seli të zyrës në Prizren, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se kreditori i përmbarimit i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm / Faturën nr.38 të datës 20.05.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkojnë me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk është e nënshkruar nga debitori mirëpo bazuar në shkresat e lëndës pranimit i faturës nga ana e debitorit vërtetohet nga shkresa me numër protokollit 1383 e datës 24.05.2021, në të cilën shkresë debitori konstaton se e ka pranuar faturën më datën 24.05.2021, andaj pranimit i së njëjtës nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga fatura andaj edhe konsiderohet si dokument i besueshëm.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga kontrata me nr.624-20-055-521/624-20-2759-521 e lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Komunën e Suharekës (këtu debitori). Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk II.nr. 142/24, dt 07.06.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**